



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 53 datë 23.11.2015

Për

**“PROPOZIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERIUDHËN 1-
30.11.2015”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 33, pika 6 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”(i ndryshuar); neneve 7, 8, 11, 20, 23, 29 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”(i ndryshuar); Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Statusi i Invalidit të Punës”(i ndryshuar); Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996, “Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar); Ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000, “Për statusin i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.06.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”(i ndryshuar);vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.01.2001, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave. nr. 618, datë 07.09.2006, “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 869, datë 18.06.2008 për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Statusi i Invalidit të Punës”; Udhëzimit nr. 1406, datë 30.07.2008, “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave. nr. 869, datë 18.06.2008, “Për zbatimin e Ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, “Statusi i invalidit”: Udhëzimit nr. 2365, datë 26.11.2008 (i ndryshuar), mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”; Udhëzimit nr.8, datë 20.09.2012 mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277 datë 18.06.1997,”Për përfitimet nga statusi i të verbërit”(i ndryshuar); Udhëzimit nr. 6, datë 07.08.2013, mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 07.09.2006, “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”(i ndryshuar); Udhëzimit nr. 7, datë 07.08.2013, mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277 datë 18.06.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbërit” (i ndryshuar); Udhëzimit nr. 5, datë 07.08.2013, mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.01.2001, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”(i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak Tiranë:

V E N D O S I:

1. Të miratohet pagesa për personat me aftësi të kufizuar, për muajin Nëntor 2015 për Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Financës, Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimeve Sociale dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI